

V E N D I M
Nr. 361, datë 14.7.2000

**PËR SHPËRNDARJEN ME KOEFICIENT PJESORË TË VLERAVE FINANCIARE,
KREDITORËVE TË SHOQËRISË “SILVA”, SH.P.K., NË ADMINISTRIM, ME TË
ARDHURAT E REALIZUARA NGA SHITJA E ASETEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, dhe të neneve 3, 4 e 8 pika 3, të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fillimin e kompensimit të pjesshëm të kreditorëve të shoqërisë “Silva”, sh.p.k., në administrim, me të ardhurat e realizuara nga shitja e aseteve në ankandet e shitjes publike me tender.
2. Shuma e detyrimit të mbetur që shoqëria “Silva”, sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve është 3 232 496 204 lekë.
 - Të ardhurat financiare të realizuara nga shitja e aseteve të shoqërisë “Silva” sh.p.k., në administrim, depozituar në bankë, së bashku me ato gjendje, kapin vlerën 640 milionë lekë.
 - Koeficienti pjestor i kthimit të vlerave financiare kreditorëve është 20,15 për qind.
3. Ngarkohet Banka e Kursimeve me degët e saj në rrethet Vlorë e Tiranë, për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Silva”, sh.p.k., në administrim.
 - Shpenzimet për shpërblimet, që do të kryhen në sportelet e Bankës së Kursimeve për kompensimin e vlerave financiare kreditorëve, përballohen nga zëri “shpenzime” i buxhetit të vitit 2000, i miratuar për Grupin e Mbikëqyrjes.
4. Administratorët e përbashkët të shoqërisë “Silva” sh.p.k., në administrim, të bashkërendojnë punën me Zyrat e Përmbarimit Gjyqësor, për arkëtimin e vlerave financiare nga personat fizikë e juridikë të shpallur debitorë, dhe nga personat që kanë përfituar vlerat financiare nga transaksionet e pronësisë, për realizimin, në një periudhë të dytë, të një rikompensimi tjetër.
5. Dokumentacioni financiar i veprimtarisë së huamarrjes së shoqërisë “Silva” sh.p.k., në administrim, t’i dorëzohen organit të prokurorisë, i cili në zbatim të Kodit të Procedurës Civile, të kërkojë në procesin gjyqësor ndaj ish administratorit, detyrim për kthim të shumave të pashlyera, sipas kontratave të kreditorëve.
6. Ngarkohen Banka e Kursimeve, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Grupi i Mbikëqyrjes dhe administratorët e përbashkët të shoqërisë “Silva”, sh.p.k., në administrim, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta